

L I G J
Nr.8514, datë 15.7.1999

**PËR RATIFIKIMIN E “AMENDAMENTIT TË KATËRT TË MARRËVESHJES
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT MONETAR
NDËRKOMBËTAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Amendamenti i katërt i Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2428, datë 22.7.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

**AMENDAMENTI I KATËRT I PROPOZUAR I NENEVE TË MARRËVESHJES TË FONDIT
MONETAR NDËRKOMBËTAR**

Qeveritë në emër të të cilave kjo Marrëveshje është nënshkruar, bien dakord si më poshtë:

1. Teksi i nenit XV, Seksioni 1 do të ndryshojë si më poshtë vijon:

(a) Për të arritur nevojën, ashtu dhe kur ajo shfaqet, për një suplement të rezervës të asetëve ekzistuese, Fondi është i autorizuar të shpërndajë të drejtat e tërheqjes speciale në përputhje me klauzolat e nenit XVIII për anëtarët që janë pjesëmarrës në Departamentin e të drejtave të Tërheqjes Speciale.

(b) Përveç kësaj, Fondi do të shpërndajë të drejtat e tërheqjes speciale për anëtarët që janë pjesëmarrës në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale në përputhje me klauzolat e Skedulit M.

2. Një skedul i ri M do t'i shtohet neneve, i cili do të lexohet si vijon:

**SKEDULI M SHPËRNDARJE SPECIALE E NJËHERSHME E TË DREJTAVE TË
TËRHEQJES SPECIALE**

1. Subjekti i pikës 4 më poshtë, secili anëtar që deri më 19 shtator 1997, është një pjesëmarrës në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale, në të 30-tën ditë të datës të amendamentit të katërt të kësaj Marrëveshjeje, do të marrë një shpërndarje të të drejtave të tërheqjes speciale në një shumë që do të rezultojë në vetë ndarjen neto të akumuluar të të drejtave të tërheqjes speciale që janë të barabarta më 29.315788813 për qind të kuotës të tij ashtu si më 19 shtator 1997, me kushtin që, për pjesëmarrësit kuotat e të cilëve nuk u rregulluan ashtu siç u

propozua në Rezolutën nr.45-2 të Bordit Ekzekutiv, llogaritjet do të bëhen në bazë të kuotave të propozuara në këtë rezolutë.

2. (a) Subjekti i pikës 4 më poshtë, secili vend që bëhet anëtar në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale pas 19 shtatorit 1997, por brenda tre muajve që nga data e anëtarësimit të tij në Fond, do të marrë një shpërndarje të të drejtave të tërheqjes speciale në një shumë të llogaritur në përputhje me (b) dhe (c) si më poshtë në ditën e 30-të që ndjek më të fundit nga: (i) data në të cilën anëtari i ri bëhet një pjesëmarrës në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale, ose (ii) data efektive e amendamentit të katërt të kësaj Marrëveshjeje.

(b) Për qëllimet e pikës (a) mësipër, secili pjesëmarrës do të marrë një shumë të të drejtave të tërheqjes speciale, e cila do të rezultojë në një shpërndarje neto kumulative të tillë të pjesëmarrësve, e cila do të jetë e barabartë me 29.315788813 për qind të kuotës së tij deri në datën në të cilën secili anëtar bëhet pjesëmarrës në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale, të korrigjuar si më poshtë:

(i) së pari, duke shumëzuar 29.315788813 për qind me raportin e totalit të kuotave, sipas përlllogaritjes 1 mësipër, të pjesëmarrësit të përshkruar si në (c) mëposhtë, ndaj totalit të kuotave të këtyre pjesëmarrësve deri në datën në të cilën secili anëtar bëhet pjesëmarrës në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale, dhe

(ii) së dyti, duke shumëzuar produktin e (i) të mësipërm me raportin e totalit të shumës të alokacioneve të akumuluar neto të të drejtave të tërheqjeve speciale të përfituara nga neni XVIII të pjesëmarrësve të përshkruar në (c) mëposhtë deri në datën në të cilën anëtari bëhet pjesëmarrës në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale dhe shpërndarjes së të drejtave të tërheqjes speciale të përfituar nga këto pjesëmarrës sipas 1 të mësipërm të totalit të shumës së shpërndarjes neto kumulative të të drejtave të tërheqjeve speciale të përfituara sipas nenit XVIII të këtyre pjesëmarrësve deri më 19 shtator 1997 dhe shpërndarjet e përfituara nga secili pjesëmarrës sipas 1 mësipër.

(c) Për qëllimet e rregullimeve që do të bëhen sipas (b) mësipër, pjesëmarrës në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale do të jenë anëtarët që janë pjesëmarrës deri më 19 shtator 1997 dhe (i) vazhdojnë të jenë pjesëmarrës në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale deri në datën në të cilën anëtari bëhet një pjesëmarrës në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale, dhe (ii) ka marrë të gjitha alokacionet e bëra nga Fondi pas 19 shtatorit 1997.

3.(a) Subjekti i 4 më sipër, në qoftë se Republika Federale e Jugosllavisë (Serbia/Mali i Zi), do të arrijnë të bëhen anëtarë në Fond dhe pjesëmarrja në Departamentin e të Drejtave të Tërheqjes Speciale të ish Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë në përputhje me termat dhe kushtet e Vendimit të Bordit Ekzekutiv Nr.10237 - (92/150) të adoptuar më 14 dhjetor 1992, ajo do të marrë si alokacion të të drejtave të tërheqjes speciale në një shumë të llogaritur në përputhje me (b) mëposhtë në ditën e 30-të që ndjek më të fundit nga: (i) data në të cilën Republika Federale e Jugosllavisë (Serbia/Mali i Zi) do të arrijnë të bëhen anëtarë të Fondit dhe të marrin pjesë në Departamentin e të të Drejtave të Tërheqjes Speciale në përputhje me termat dhe kushtet e Vendimit të Bordit Ekzekutiv Nr.10237 - (92/150), ose (ii) të datës efektive të amendamentit të katërt të kësaj Marrëveshjeje.

(b) Për qëllimet e (a) të mësipërme, Republika Federale e Jugosllavisë (Serbia/Mali i Zi) do të marrin një shumë të të drejtave të tërheqjes speciale që do të rezultojë në alokacionin neto kumulativ të barabartë me 29.315788813 për qind të kuotave të propozuara sipas paragrafit 3(c) të Vendimit të Bordit ekzekutiv Nr.10237-(92/150), të rregulluar në përputhje me 2(b)(ii) dhe (c) të mësipërme deri në datën në të cilën Republika Federale e Jugosllavisë (Serbia/Mali i zi) do të kualifikohen për një alokacion sipas (a) të mësipërme.

4. Fondi nuk do të shpërndajë të drejtat e tërheqjes speciale sipas këtij Skeduli për ata pjesëmarrës të cilët ia kanë bërë të ditur Fondit me shkresë përpara datës së alokacionit se ata nuk duan ta marrin alokacionin.

5. (a) Në qoftë se në kohën kur alokacioni është bërë një pjesëmarrës sipas 1,2 ose 3 të

mësipërm, pjesëmarrësi ka tejkalluar detyrimet ndaj Fondit, të drejtat e tërheqjes speciale të alokuara do të depozitohen dhe do të mbahen në një llogari escrow brenda Departamentit të Drejtave të Tërheqjes Speciale dhe do t'i njoftohet pjesëmarrësit për të çliruar atë nga detyrimet e Fondit.

(b) Të drejtat e tërheqjes speciale duke qenë në një llogari escrow nuk do të mund të përdoren për ndonjë shërbim dhe nuk do të përfshihen në ndonjë llogaritje të alokacioneve të drejtave të tërheqjes speciale për qëllimet e neneve, përveç përlllogaritjeve sipas këtij Skeduli. Në qoftë se të drejtat e tërheqjes speciale të alokuara një pjesëmarrësi të cilat ndodhen në këtë llogari escrow, atëherë kur pjesëmarrësi përfundon pjesëmarrjen e tij në Departamentin e Drejtave të Tërheqjes Speciale ose kur është caktuar të likuidohet Departamenti i të drejtave të Tërheqjes speciale, këto të drejta të tërheqjes speciale do të anulohen.

(c) Për qëllimet e këtij paragrafi, detyrimet që u ka kaluar afati ndaj Fondit konsistojnë në riblerjet dhe pagesat në Llogarinë e Përgjithshme të Burimeve, në principalet dhe interesat për kreditë në Llogarinë Speciale të Disbursimit, në pagesat dhe vlerësimet në Departamentin e Drejtave të Tërheqjes Speciale dhe detyrimet e Fondit si trust.

(d) Përveç kushteve të këtij paragrafi, principet e ndarjes ndërmjet Departamentit të Përgjithshëm dhe Departamentit të Drejtave të Tërheqjes Speciale dhe karakteri i pakushtëzuar i të drejtave të tërheqjes speciale si mjete rezervë do të mbahet.